

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MANON” Sh.p.k.
ME SELI NË TIRANË



(Rruga “Ibrahim Rrugova”, Njesia bashkiake nr.5, Pall.16)

Sot, më datë 12 Maj 2022 (dymije e njezete e dy), ne personat e meposhtem, ne cilesine e themeluesve se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, “MANON” Sh.p.k.,

1.Aglaija Trigka, atesia Nikolaos, e datëlindjes 13/11/1965, lindur ne Trikala, Greqi dhe banuese ne Trikala, Greqi, shtetase greke, identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. AP1021785, perfaqesuar nepermjet Prokures se posacme me nr. 2.418 date 10/05/2022, nenshkruar para Noter Larisas Ekaterini Vasileiou, pajisur me Apostille me nr. 77/10-05-2022 nga Kristi Pulluqi, i datëlindjes 30/12/1994, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese: shtetas shqiptar , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J41230043Q

2.Kristi Pulluqi, atesia Polikron, i datëlindjes 30/12/1994, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese: Rruga e Vilave, TEG, Tirane , shtetas shqiptar , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J41230043Q

3.Nerjada Muçaj, atesia Sokol, e datëlindjes 27/04/1996, lindur ne Ballsh dhe banuese ne Tirane, me adrese: Tirane, Rruga “Rrapo Hekali”, Selite, shtetase shqiptare , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J65427091N,

në mbështetje të legjislacionit shqiptar, respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, hartoj këtë Akt themelimi, sipas përcaktimeve të mëposhtëme:

NENI 1

Themelimin e Shoqërisë Tregtare “MANON” Sh.p.k., në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “MANON” Sh.p.k., sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është Aktiviteti ne fushen e ofrimit te sherbimeve te ndryshme ne fushen tregtare, financiare, civile, që kanë lidhje direkte apo indirekte me objektin tregtar si dhe me objekte te ngjashme apo të lidhura me të, si dhe çdo veprimtari tjetër që i shërben rritjes dhe zhvillimit të kësaj shoqërie që janë në përputhje me legjislacionin shqipëtar.

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3


Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “MANON” Sh.p.k., Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

- 
1. Ne fushen e tregëtise import eksport, me shumice e pakice, te mallrave ushqimore.
 2. Ne fushen e sherbimeve shendetesore, si laborator , qender masazhi, sherbime kozmetike.
 3. Ne fusha te tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, kreperive, agjensi transporti, transport te udhetareve dhe mallrave si brenda dhe jashte vendit.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, ne adresën: **Rruga "Ibrahim Rrugova", Njesia bashkiake nr.5, Pall.16, Tirane, Shqipëri**. Me vendim të Asamblese se ortakeve, shoqëria mund të hapë degë, filiale ose përfaqësi, ashtu sikundër do ta shohë të nevojshme, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara me ligj ose me vendim të Ortakut te vetem, sipas përcaktimeve në statut.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie. **Kapitali themeltar i kesaj shoqerie do te jete 120 000 Leke (njqind e njetzet mije Leke)**

NENI 7

Ortaket themelues te Shoqërisë Tregtare "**MANON**" **Sh.p.k.**, kane ne zoterim si me poshte:

1. **Aglaia Trigka** ka ne zoterim 50% te kapitalit te shoqerise ose 1 (nje) kuote me vleren e 60,000 (gjashtedhjetete mije) Leke.
2. **Kristi Pulluqi** ka ne zoterim 25% te kapitalit te shoqerise ose 1 (nje) kuote me vleren e 30,000 (tridhjetete mije) Leke.
3. **Nerjada Muçaj** ka ne zoterim 25% te kapitalit te shoqerise ose 1 (nje) kuote me vleren e 30,000 (tridhjetete mije) Leke.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asamblea e Përgjithshme – organi më i lartë vendimarrës.

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit te shoqerise, i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administrator i shoqërisë do të jetë **Kristi Pulluqi**, atesia Polikron, i datëlindjes 30/12/1994, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J41230043Q



SHQIPËRI
SOL
NOTER
TANË

Shoqëria përfaqësohet për çdo organ administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Akti i themelimit u hartua nga Ortakët Themelues, dhe u nënshkrua prej tyre, pranë vendit të themelimit të Shoqërisë. Ky Akt Themelimi hartohet në katër kopje me vlerë të njëjtte juridike.

ORTAKËT THEMELUES

Aglaia Trigka

Prokure te Posacme nga Kristi Pulluqi

Kristi Pulluqi
Pulluqi

Kristi Pulluqi

Kristi Pulluqi
Pulluqi

Nerjada Muçaj

Nerjada Muçaj
Muçaj

**STATUTI I**
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MANON” Sh.p.k.
ME SELI NË TIRANË
(Rruga “Ibrahim Rugova”, Njesia bashkiake nr.5, Pall.16)

TITULLI I

Neni 1: Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja, selia dhe hapësira në Internet, Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit

(1) Sot, në Tirane, më 12 Maj 2022 (dymijë e njezet e dy), në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne, themeluesit kemi krijuar, një Shoqëri me emërtimin “**MANON**” **Sh.p.k.**, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare me,

(2) Ortakë themelues të shoqërisë:

1.Aglaia Trigka, atesia Nikolaos, e datëlindjes 13/11/1965, lindur ne Trikala, Greqi dhe banuese ne Trikala, Greqi, shtetase greke, identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. AP1021785, perfaqesuar nepermjet **Prokures se posacme** me nr. 2.418 date 10/05/2022, nenshkruar para Noter Larisas Ekaterini Vasileiou, pajisur me Apostille me nr. 77/10-05-2022 nga Kristi Pulluqi, i datëlindjes 30/12/1994, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese: Rruga e Vilave, TEG, Tirane, shtetas shqiptar , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J41230043Q

2.Kristi Pulluqi, atesia Polikron, i datëlindjes 30/12/1994, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese: Rruga e Vilave, TEG, Tirane, shtetas shqiptar , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J41230043Q

3.Nerjada Muçaj, atesia Sokol, e datëlindjes 27/04/1996, lindur ne Ballsh dhe banuese ne Tirane, me adrese: Tirane, Rruga “Rrapo Hekali”, Selite, shtetase shqiptare , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J65427091N

Neni 2: Objekti

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**MANON**” **Sh.p.k.**, do të zhvillojë aktivitetet me objektin e veprimtarisë si më poshtë:

1. Ne fushen e tregëtisë import eksport, me shumice e pakice, te mallrave ushqimore.
2. Ne fushen e shërbimeve shëndetësore, si laborator , qender masazhi, shërbime kozmetike.
3. Ne fusha te tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, kreperive, agjensi transporti, transport te udhetareve dhe mallrave si brenda dhe jashte vendit.

Per arrijten e ketij qellimi shoqëria ka te drejten te bashkepunoje me persona juridike ose fizike ose me cilendo tjetër Shoqeri me te njejtin objekt brenda vendit ose jashte vendit qe ka te njejtin qellim.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare “**MANON**” - **Sh.p.k.**, . është e pakufizuar.

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MANON” SH.P.K

Faqe 1





Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

Selia e Shoqërisë Tregtare "MANON" - Sh.p.k., është në Tiranë, në adresën; *Rruga "Ibrahim Rrugova", Njesia Bashkiake nr.5, Pall.16, Tiranë, Shqipëri.*

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e R.SH., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

(1) Adresa e Shoqërisë për qëllimin e komunikimit elektronik është si vijon:

- a. Tel : 0692064229
- b. Email: info@manon.al
- c. Web: www.manon.al

TITULLI II

Kapitali

Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

(1) Kapitali themeltar i Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar "MANON" - Sh.p.k., është 120000 (njqind e nejtet mije) Lekë , i cili perben nje kuote me vlerë nominale 120 000 leke (njqind e nejtet mije) Lekë, e cila eshte ne zoterim te Ortakeve themelues te shoqerise si me poshte:

Aglaia Trigka ka ne zoterim 50% te kapitalit te shoqerise ose 1 (nje) kuote me vleren e 60,000 (gjashtedhjetet mije) Leke.

Kristi Pulluqi ka ne zoterim 25% te kapitalit te shoqerise ose 1 (nje) kuote me vleren e 30,000 (tridhjetet mije) Leke.

Nerjada Muçaj ka ne zoterim 25% te kapitalit te shoqerise ose 1 (nje) kuote me vleren e 30,000 (tridhjetet mije) Leke.

(2) Kontributet e mësipëme janë shlyer tërësisht.

Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe tërheqja e kuotave të papaguara

(1) Administratori mund t'i kërkojë ortakut të paguajë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat që zoteron , në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën, katërmëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, si përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpashëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet thirrja për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote, mbajnë përgjegjësi bashkarisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.

(3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japë një njoftim prej jo më pak se katërmëdhjetë ditësh të plota personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, përgjigjen duke

u anuluar.

- (4) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, mund të tërhiqet me vendim të Administratorit dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.
- (5) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderohet e arsyeshme nga administratori.

Neni 7: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet

Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar me 75%(shtatedhjetë e pese përqind) të kapitalit të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 8: Çertifikatat e kuotave të kapitalit

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një çertifikatë për të kuotën që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e çertifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72, paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në çertifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

Neni 9: Kalimi i kuotave me kontratë

- (1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të Shoqërisë.
- (2) Administratori mund të mos pranojë ta regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKB-së, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi.
- (3) Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, ata, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

Neni 10: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit

- (1) Nëse ortaku vdes, në rastin kur është zotërues i vetëm ose një bashkëzotërues i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij, janë të vetmit persona, të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij; Por, asnjë dispozitë e këtushme, nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkarisht.
- (2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjetër.
- (3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.



Neni 11: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- (1) Asambleja e Përgjithshme, e përbere nga ortakët, mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotën e ortakut ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% (shtatedhjetepese përqind) të kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, ortakët do të ketë të drejtë të nënshkruajë zmadhimin e tij në proporcion me pjesën e tij në kapital. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.
- (2) Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% (shtatedhjetepese përqind) të kapitalit. Në rast zvogëlimi të kapitalit themeltar, ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajë zvogëlimin e tij në proporcion me pjesën e tij në kapital. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

Neni 12: Transferimi dhe shitja e kuotave

Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të bëhet me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e shoqërisë.

**TITULLI III
Asambleja e Përgjithshme**

Neni 13: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- (I) Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
- (II) Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët themelues. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët themelues, regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
- (III) Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

**TITULLI IV
Administratori**

Neni 14: Emërimi i administratorit

- (1) Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të vetëm të shoqërisë për 5 (pesë) vjet sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi me votën pro të shumicës së zakonshme, të kapitalit themelues,

- nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.
- (2) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorit parashikohen në Nenin 95, paragrafi (2) i Ligjit.
- (3) Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i saj **Kristi Pulluqi**, atesia Polikron, i datëlindjes 30/12/1994, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese: Rruga e Vilave, TEG, Tirane, shtetas shqiptar , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J41230043Q, i cili emërohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5(pesë)vjeçare, me të drejtë rimerimi.

Neni 15: Kompetencat e Administratorit

(1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit (6).


Administratori ka këto të drejta dhe detyrime:

- të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- të përfaqësojë shoqërinë, në mënyrë aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, pra, edhe me lëshimin e prokurave, mandateve të veçanta për avokatë, mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarrëveshje; të lëshojnë ose të revokojnë mandate *ad lites* avokatëve dhe mbrojtësve dhe *ad negotia* punonjësve të shoqërisë ose të tretëve për një ose më shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;
- të kryejë çdo operacion financiar dhe/ose tregtar (kontrata *leasing*; operacione cedimi kredie) aktive dhe pasive, që ka lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqërisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përmbushje të formaliteteve të nevojshme, duke përfshirë dorëzimin, të çelini llogari rrjedhëse bankare, të kryejë tërheqje parash, të japë dispozita të pagesës, të firmosë çeqe që të kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, edhe të zbuluar, në kufijtë e besueshmërisë së atij momenti (*overcover*), të verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe të miratojë llogarinë;
- të punësojë, të pezullojë, të pushojë nga puna dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;
- të ndërveprojë me Entet e Administratës Publike për çdo negociim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;
- të lëshojë ekstrakte të borderove dhe vërtetime që lidhen me personelin, si për entet e sigurimeve shoqërore, ashtu dhe për ente të tjera ose private; të kujdeset për respektimin e përmbushjeve, ndaj të cilave shoqëria është e detyruar, me të drejtën për të nënshkruar deklarata tatimore, që kanë lidhje me mbajtjet nga të ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;
- të nënshkruajë deklarata fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësime nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shkalle, me të drejtën për të emëruar mbrojtës të posaçëm;
- të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e konçesioneve, liçencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës të posaçëm;

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"MANON" SH.P.K

Faqe 5





- të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhëse dhe ekstrakteve periodike të llogarive rrjedhëse për vartësit e shoqërisë për shumat e depozituara pranë saj;
 - të nënshkruajë kontrata shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë;
 - të ndërtojë, të përfundojë dhe të administrojë marrëdhënie bankare, duke rënë dakord mbi afatet dhe kushtet;
 - të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumentave të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;
 - të përfaqësojë shoqërinë në asambltetë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emërojë përfaqësues, të delegojë me mandat dhe/ose prokurë, aq sa i takon kompetencave të tij.
- (2) Administratori mund t'ia delegojë kompetencat e tij komiteteve që përbëhen nga një ose më shumë anëtarë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vendosë Administratori dhe mund të revokohet ose të ndryshohet.
- (3) Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të kishin qenë të vlefshme, nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishin dhënë direktiva.
- (4) Administratori nuk mund të delegojë asnjëherë prej detyrimeve, të cilat ia ngarkon ligji.

Neni 16: Skualifikimi dhe largimi i administratorit

- (1) Posti i Administratorit lirohet nëse:
1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit, përfshirë Nenin 95 paragrafi (6).
 2. hyn në procedurën e paaftësisë paguese;
 3. vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
 4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën Shoqërisë; ose
 5. ka munguar për më shumë se tre muaj radhazi pa leje në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë ose Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Ortakëve të tjerë vendos ta lirojë nga detyra.

Neni 17: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit

- (1) Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë ekzistuese, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla (si përpara ashtu dhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).

Neni 18: Vendimet e Mbledhjeve të Administratorit

- (1) Mbledhjet e Administratorit mbahen sa herë ta kërkojë aktiviteti i shoqërisë.

- (2) Të gjitha aktet e kryera nga Administratori ose nga një person që ushtron detyrën e caktuar nga Administratori, pavarësisht faktit nëse më vonë zbulohet se ka pasur mangësi në emërimin e tij ose ka qenë i skualifikuar nga e drejta për të mbajtur detyrën ose nuk ka pasur të drejtë vote, janë të vlefshëm njësoj sikur të gjithë këta persona të ishin emëruar rregullisht, të plotësonin kushtet, të vazhdonin të ishin Administratorë.

Neni 19: Procesverbalet e mbledhjeve të Administratorit

1. Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë procesverbalet e të gjitha takimeve të bëra nga Administratori.
2. Të të gjitha punimeve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjeve të Administratorit dhe të komiteteve të krijuara nga Administratori, përfshirë edhe emrat e personave të ftuar të pranishëm në këto mbledhje.

KAPITULLI V

Dividentët dhe kapitalizimi i fitimeve

Neni 20: Dividentët

- (1) Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumatat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend, duke filluar nga një datë e caktuar atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.
- (3) Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuota nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.
- (4) Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

Neni 21: Kapitalizimi i fitimeve

Me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, Administratori mund të vendose të kapitalizojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividende preferenciale ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

TITULLI IV

Neni 22: Prishja dhe Likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës,

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t’i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund t’i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

Neni 23: Njoftimet

Njoftimet që i jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit, duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik sipas adreses që shoqëria do të ketë në internet dhe që është i vlefshëm në momentin që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bëri njoftimin.

Neni 24: Dispozita të përgjithshme

Përsa i përket çështjeve që nuk janë parashikuar nga ky statut, do të aplikohen dispozitat e Shoqërive me Përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakut dhe shoqërisë në lidhje me raportet shoqërore ose për interpretimin dhe zbatimin e këtij statuti dhe të vendimeve ligjërish të nxjerra nga organet e shoqërisë, ato të emëruara nga administratorët, likuidatorët dhe titullarët ose në raportet me ta, për sa janë shtruar për kompromis, do t’i paraqiten Gjykatës në Rrethin në të cilin shoqëria ka selinë.

Neni 25: Dispozita përfundimtare

Ky Statut përpilohet në 3(tre) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Statuti mbyllet me 25 (Njëzet e pese) nene. Ky statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKB.

**ORTAKET THEMELUES
“MANON” SH.P.K.**

Aglaia Trigka

*Perfaqesuar me Prokure te Posacme
nga Kristi Pulluqi*

Kristi Pulluqi
Pulluqi

Kristi Pulluqi

Kristi Pulluqi
Pulluqi

Nerjada Muçaj

Nerjada Muçaj
Muçaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ADRIANA J. SOLIS



DATE 12/05/2022
NR REP 359

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 12/05/2022 (Dymije e njezet e dy), para meje Notere ADRIANA J. SOLIS, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.88, u paraqiten personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

1.Aglaiia Trigka, atësia Nikolaos, amësia Eleni, shtetase greke, lindur në Trikala, Greqi dhe banuese në Larisa, Rruga Kuprou, nr.97, Greqi lindur më 13/11/1965, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. AP1021785 perfaqesuar nepermjet *Prokures se posacme* me nr. 2.418 date 10/05/2022, nenshkruar para Noter Larisas Ekaterini Vasileiou, pajisur me Apostille me nr. 77/10-05-2022 nga **Kristi Pulluqi**, i datëlindjes 30/12/1994, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese: shtetas shqiptar , identifikuar nepermjet Pasaportes me nr. Personal. J41230043Q

2.Kristi Pulluqi, atësia Polikron, amësia Angjelina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tirane , me adresë Rruga e Vilave, TEG, Nd. 31; H. 1; Farkë; Lundër; 1045; Tiranë, lindur më 30/12/1994, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033281816 dhe nr. personal J41230043Q , .

3.Nerjada Muçaj, atësia Sokol, amësia Mirela, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, Mallakastër dhe banues në Tirane, me adresë: rruga "Rrapo Hekali", 03910112; Nd. 27; H. 8; Ap. 26; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 27/04/1996, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032512722 dhe nr. personal J65427091N ,

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MANON" shpk", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ADRIANA J. SOLIS

ΑΙΚΑΤΕΡΙΝΗ Δ. ΒΑΣΙΛΕΙΟΥ

ΣΥΜΒΟΛΑΙΟΓΡΑΦΟΣ

ΚΟΥΜΑ 4 - 41222 - ΛΑΡΙΣΣΑ

ΤΗΛ. 2413019775

ΑΦΜ 047010021 - ΔΟΥ ΛΑΡΙΣΣΑΣ

Email: katvas9987@gmail.com, katvas9987@yahoo.gr



ΑΝΤΙΓΡΑΦΟ


ΑΡΙΘΜΟΣ **2.418**

ΕΙΔΙΚΟ ΠΛΗΡΕΞΟΥΣΙΟ

Στη Λάρισα σήμερα στις **δέκα (10)** του μηνός **Μαΐου** του έτους δύο χιλιάδες δέκα είκοσι δύο (**2022**), ημέρα **Τρίτη**, στο γραφείο μου που βρίσκεται στον τρίτο όροφο της επί της οδού Κούμα αριθμός 4 οικοδομής, σε μένα τη Συμβολαιογράφο Λάρισσας **ΑΙΚΑΤΕΡΙΝΗ ΒΑΣΙΛΕΙΟΥ του Δημητρίου και της Βαλεντίνης**, που έχω έδρα και κατοικία στη Λάρισα, με ΑΦΜ 047010021 ανήκουσα στην Δ.Ο.Υ. Λάρισσας, παρουσιάσθηκε η γνωστή μου και μη εξαιρούμενη από το νόμο **η Αγλαΐα Τρίγκα του Νικολάου και της Ελένης**, Ιατρός, με Α.Φ.Μ. 052457060 της Δ.Ο.Υ. Λάρισσας, γεννηθείσα στα Τρίκαλα την 13-11-1965, κάτοικος Λάρισσας, οδός Κύπρου αριθμός 97, κάτοχος του Δελτίου Αστυνομικής Ταυτότητας υπ' αριθμόν AN 315546/02-12-2016 εκδοθέντος από το Α.Δ. Λάρισσας.

Η ανωτέρω ζήτησε τη σύνταξη του παρόντος, με το οποίο δήλωσε ότι διορίζει **ειδικό πληρεξούσιο, αντιπρόσωπο και αντίκλητο της** τον ον. Kristi (Κρίστι) επιθ. Pulluqi (Πουλούκι), γεννηθέντα στα Τίρανα Αλβανίας την 30-12-1994, κάτοικο Αλβανίας, κάτοχο του Διαβατηρίου υπ' αριθμόν BA4105964 με ημερομηνία έκδοσης 04-01-2017 και ημερομηνία λήξης 03-01-2027 που εκδόθηκε από την Δημοκρατία της Αλβανίας, με προσωπικό αριθμό J41230043Q, **προς τον οποίο χορηγεί την ειδική εντολή,**

**την πληρεξουσιότητα και το δικαίωμα όπως αντ' αυτής
και για λογαριασμό της:**



Να την εκπροσωπεί ενώπιον παντός φυσικού ή νομικού προσώπου και ενώπιον των αρμοδίων αρχών οργάνων της Δημοκρατίας της Αλβανίας σε οποιαδήποτε πόλη αυτής και να υπογράφει αντ' αυτής και για λογαριασμό της όλα τα απαραίτητα έγγραφα για την σύσταση εταιρείας περιορισμένης ευθύνης (LLC), η οποία θα έχει την επωνυμία «MANON», με την ιδιότητα αυτή της μετόχου της εταιρείας και ιδρυτικού μέλους αυτής με ποσοστό συμμετοχής 50% εξ αδιαιρέτου με μετοχικό κεφάλαιο ύψους ευρώ χιλίων (1.000,00€), με όρους και συμφωνίες κατά την κρίση του. Κατόπιν της συστάσεως της άνω εταιρείας να την εκπροσωπεί και να την υποκαθιστά σε όλα τα δικαιώματα και τις υποχρεώσεις της που απορρέουν από το εταιρικό καταστατικό.

Να συμμετέχει για λογαριασμό της εντολέως σε όλες τις συνελεύσεις της εταιρείας, τακτικές ή έκτακτες και να ψηφίζει σε οποιοδήποτε θέμα της ημερησίας διατάξεως, χωρίς κανένα περιορισμό και επιφύλαξη, να υπογράφει τα σχετικά πρακτικά και οποιαδήποτε άλλα βιβλία της εταιρείας ή έγγραφα και εν γένει να ασκεί όλα τα δικαιώματά της και να ανταποκρίνεται στις υποχρεώσεις του, σύμφωνα με το καταστατικό και το Νόμο.

Να την εκπροσωπεί ενώπιον της Αρμόδιας Δημόσιας Οικονομικής Υπηρεσίας (Δ.Ο.Υ.), της Αρμόδιας Δημοτικής Αρχής καθώς και κάθε άλλης Δημόσιας Υπηρεσίας χρειαστεί για την διεκπεραίωση οποιασδήποτε διαδικασίας για την σύσταση της άνωθεν εταιρείας περιορισμένης ευθύνης, να υπογράφει κάθε είδους έγγραφα ακόμη και υπεύθυνες δηλώσεις με οποιοδήποτε περιεχόμενο.



Να συναινεί για λογαριασμό της εντολέως σε οποιαδήποτε τροποποίηση του καταστατικού της με οποιοδήποτε περιεχόμενο.

Να διορίζει και άλλους πληρεξουσίου, δικηγόρους ή όχι, με τις ίδιες ή λιγότερες εντολές και να τους ανακαλεί νόμιμα. Η εντολέας δήλωσε ότι εγκρίνει και αναγνωρίζει από σήμερα όλες τις πράξεις του πληρεξουσίου της, που ενήργησε ή θα ενεργήσει στα πλαίσια των παρεχομένων εντολών, ως νόμιμες, έγκυρες, ισχυρές και απρόσβλητες και σαν να έγιναν από αυτήν την ίδια και ότι το πλήρεξούσιο αυτό ισχύει μέχρι να ανακληθεί και να γνωστοποιηθεί νόμιμα η ανάκλησή του.

Σε βεβαίωση όλων των ανωτέρω συντάχθηκε το πλήρεξούσιο αυτό, σε δύο (2) φύλλα. Επικολλήθηκε τέλος μεγαροσήμου ενός (1) ευρώ για το πρωτότυπο και δύο (2) ευρώ για το αντίγραφο. Για δικαιώματα του παρόντος, καθώς και για δικαιώματα εκδόσεως ενός (1) αντιγράφου εισπράχθηκαν ευρώ τριάντα έξι (36,00€). Επί των εισπραχθέντων δικαιωμάτων εισπράχθηκε Φ.Π.Α. ευρώ οκτώ και εξήντα τέσσερα εκατοστά του ευρώ (8,64€).

Το πλήρεξούσιο αυτό διάβασα καθαρά και μεγαλόφωνα, για να το ακούσει η εντολέας, η οποία βεβαίωσε ολόκληρο το περιεχόμενό του και το υπέγραψε, καθώς και εγώ η συμβολαιογράφος, όπως ο νόμος ορίζει.

Η ΕΝΤΟΛΕΑΣ

Η ΣΥΜΒΟΛΑΙΟΓΡΑΦΟΣ

ΑΚΟΛΟΥΘΟΥΝ ΥΠΟΓΡΑΦΕΣ

Η ΣΥΜΒΟΛΑΙΟΓΡΑΦΟΣ
(Τ.Σ.) Αικατερίνη Δ. Βασιλείου
Ακριβές αντίγραφο - Λάρισα αυθιμερών
Η Συμβολαιογράφος, Λάρισα



Βεβαιώνεται το γνήσιο της υπογραφής του ανωτέρω δηλούντος
Λάρισα 10/05/2021
Πρόεδρος Πρωτοδικών

ΟΛΥΜΠΙΑ ΚΩΣΤΑ
ΠΡΟΕΔΡΟΣ ΠΡΩΤΟΔΙΚΩΝ



Τα δικαιώματα του παρόντος αντιγράφου εισπράχθηκαν και αναφέρονται στο πρωτότυπο του συμβολαίου, μη απαιτούμενης της εκδόσεως ΔΑΠΥ, σύμφωνα με το άρθρο 3 παρ. 4 του Κ.Β. κ.Σ.



APOSTILLE – Επιστημείωση
(CONVENTION DE LA HAYE 5 OCTOBRE 1961/
Συμβάση της Χάγης της 5 Οκτωβρίου 1961)

1. Χώρα ΕΛΛΑΣ
PAYS GRECE
Το παρόν δημόσιο έγγραφο
LE PRESENT ACT PUBLIC

2. έχει υπογραφεί από... την Αικατερίνη Βασιλείου
A ETE SIGNE PAR.....

3. που ενήργησε με την ιδιότητα τῆς Συμβολαιογράφου Λάρισας
AGISSANT EN QUALITE DE.....

4. φέρει τη σφραγίδα / επίσημα τῆς Συμβολαιογράφου Λάρισας
EST REVETU DU SCEAU / TIMBRE DE.....

Η βεβαίωση χορηγείται / ATTESTE

5. (τόπος) ΛΑΡΙΣΑ
A.....

6. (ημερομηνία) 10/05/2022
LE.....

7. από τῆς ΠΡΟΕΔΡΟΥ ΥΠΗΡΕΣΙΑΣ ΠΡΩΤΟΔΙΚΕΙΟΥ ΛΑΡΙΣΑΣ
PAR..... **ΟΛΥΜΠΙΑ ΚΩΣΤΑ**
ΠΡΟΕΔΡΟΣ ΠΡΩΤΟΔΙΚΩΝ

8. με αριθμό 77/10-05-2022
SOUS NO.....

9. Σφραγίδα / επίσημα
SCEAU / TIMBRE

10. Υπογραφή
SIGNATURE




ΟΛΥΜΠΙΑ ΚΩΣΤΑ
ΠΡΟΕΔΡΟΣ ΠΡΩΤΟΔΙΚΩΝ



EKATERINI VASILEIOU
NOTERE
KOUMA 4 – 41222 LARISA
TEL. 2413019775
A.F.M. (NIPT) 047010021



KOPJE
NUMËR 2.418
PROKURË E POSAÇME

Në Larisa sot më datë **dhjetë (10)** të muajit Maj të vitit dy mijë e njëzet e dy (2022), dita e javës e **Martë**, në zyrën time të noterisë, që ndodhet në katin e tretë të pallatit, në rrugën Kouma 4, përpara meje noteres së Larisas EKATERINI VASILEIOU, i biri i Dimitris dhe i Valentini, që kam seli dhe banim në Larisa, A.F.M. (NIPT) 047010021, që i përket Shërbimit Ekonomik Publik Larisa, u paraqit e njohura prej meje dhe e papërgjashtuara nga ligji **Aglaia Trigka e bija e Nikolaos dhe e Eleni**, mjeke, me A.F.M. (NIPT) 052457060 i Shërbimit Ekonomik Publik Larisa, e lindur në Trikala më datë 13-11-1965, banuese në Larisa, rruga Kuprou numër 97, mbajtëse e kartës së identitetit me numër AN 315546/02-12-2016 e lëshuar nga Rajoni i Policisë Larisa.

E sipërpërmendura më kërkoi hartimin, e kësaj prokure me të cilën deklaroi se **emëron dhe cakton përfaqësues të posaçëm të saj Kristi Pulluqi**, i lindur në Tiranë, Shqipëri më datë 30-12-1994, banues në Shqipëri, mbajtës i pasaportës me numër BA4105964 me datë lëshimi 04-01-2017 dhe datë skadimi 03-01-2027, e lëshuar nga Republika e Shqipërisë, me numër personal J41230043Q, të cilit i jep **porosinë e vecantë, të drejtën dhe tagrat, që në emër dhe për llogari të saj:**

Ta përfaqësojë përpara cdo personi fizik apo juridik dhe përpara organeve kompetente të Republikës së Shqipërisë, në cdo qytet të saj dhe të nënshkruajë në emër dhe për llogari të saj të gjitha dokumentat e nevojshme për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (LLC), e cila do ketë emërtimin "MANON", me cilësinë e saj si ortakë e shoqërisë dhe anëtarit themelues të saj me përqindje pjesëmarrjeje 50% e pandashme, me kapital në shumën një mijë euro (1.000,00 €), me kushte dhe marrëveshje sipas gjykimit të tij. Pas themelimit të shoqërisë së mësipërme, për ta përfaqësuar dhe zëvendësuar në të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj që rrjedhin nga statuti i shoqërisë.

Të marrë pjesë për llogari të porositëses në të gjitha asambljetë e shoqërisë, të zakonshme apo të jashtëzakonshme dhe të votojë për cdo çështje të rendit të ditës, pa asnjë kufizim dhe rezervë, të nënshkruajë procesverbalet përkatëse dhe cdo libër apo dokument tjetër të shoqërisë dhe në përgjithësi të ushtrojë të gjitha të drejtat e saj dhe të përmbushë detyrimet e tij, në përputhje me statutin dhe ligjin.

Ta përfaqësojë përpara Shërbimit Ekonomik Publik Kompetent, Autoritetit Bashkiak Kompetent si dhe përpara cdo Shërbimi tjetër Publik që është e nevojshme për kryerjen e cdo procedure për themelimin e shoqërisë së mësipërme me përgjegjësi të kufizuar, të nënshkruajë cdo lloj dokumenti, madje dhe deklarata me përgjegjësi me cdo lloj përmbajtje.

Të japë pëlqimin për llogari të porositëses për cdo ndryshim të statutit të saj me cdo lloj përmbajtje.

Të caktojë dhe përfaqësues të tjerë, avokatë ose jo, me të njëjtat ose më pak tagra dhe t'i revokojë sipas ligjit. Porositësja deklaroi se i miraton dhe njeh që sot të gjitha veprimet e përfaqësuesit të saj që ka kryer apo do të kryejë, në kuadër të porosive të dhëna, si të ligjshme, të vlefshme dhe të pakundërshtueshme dhe sikur t'i kishte kryer ajo vet. Kjo prokurë është e vlefshme deri sa të revokohet dhe të njoftohet sipas ligjit revokimi i saj.



Konventa e Hages e dates 5 Tetor 1961

1. Shteti GREQI
Ky document publik
2. Eshte nenshkruar nga **EKATERINI VASILEIOU**
3. Qe ka vepruar ne cilesine e Noteres se Larisa
4. Kavulen/ zyrtare
Te noteres se mesiperme
Ky vertetim leshohet
5. (vendi) Larisa
6. (data) 10-05-2022
7. Nga **Gjykata e Shkalles se Pare Larisa**
8. Me nr **77/10-05-2022**
9. Vula / zyrtare
10. Nenshkrimi

PËRKTHYESE ZYRTARE
ROZETA KOXHAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARË E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ADRIANA J. SOLIS



V2022051090030065667

DATE 12/05/2022
NR REP 360

VËRTETIM PËRKTHIMI

Vërtetohet firma e përkthyeses Rozeta Mitri Koxhaj, përkthyesë zyrtare e gjuhës greke, banuese në Tiranë, rruga "Hamdi Sina", identifikuar me Kartë Identiteti ID 024410862 dhe numër personal H95311064D, me adresë email. rozikoxhaj@gmail.com, cel. 00355692728247, e njohur personalisht prej meje Noterit, e cila deklaroi se ka përkthyer nga greqisht në shqip në përputhje me origjinalin dhe e nënshkroi atë, në praninë time.

NOTER
ADRIANA SOLIS

ΑΛΒΑΝΙΚΗ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ

ΣΥΛΛΟΓΟΣ ΣΥΜΒΟΛΑΙΟΓΡΑΦΩΝ ΤΙΡΑΝΩΝ

ΒΕΒΑΙΩΣΗ ΜΕΤΑΦΡΑΣΗΣ

Βεβαιώνεται η υπογραφή της μεταφράστριας Rozeta Mitri Koxhaj, επίσημη μεταφράστρια, κάτοικος Τιράνων, οδός "Hamdi Sina", κάτοχος του υπ' αριθμού 024410862 Δελτίο Ταυτότητας και πρωσικό αριθμό H95311064D, κάτοικος Τιράνων και αναγνωρισμένη προσωπικώς από μένα το Συμβολαιογράφο, η οποία δήλωσε ότι, μετάφρασε από ελληνικά στα αλβανικά, σύμφωνα με το γνήσιο και το υπέγραψε αυτό, μπροστά μου.

ΣΥΜΒΟΛΑΙΟΓΡΑΦΟΣ
ADRIANA SOLIS

